

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë kërkon dënim me 6 vite burgim për Thaçin për pengim të drejtësisë, mbrojtja kërkon lirimin e tij
ADRESA	https://albeu.com/lajme/zyra-e-prokurorit-te-specializuar-ne-hage-kerkon-denim-me-6-vjet-burgim-per-thacin-per-pengim-te-drejtjesise-mbrojtja-kerkon-lirimin-e-tij/1005838/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 13:26:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 13:23:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	525d9918b30c47e5fe7bc4fcafcc08201d959aa0a4e1c1f890bcdf5650bfc354
TEKSTI	02e4e9642076c41ea3c1bb423daebad249ba2018c6e4cfa620f63546483cd4b1
PAMJA	3fd0d38b6d4da8db38789291bcb8643c9e9af839adcaa6867adc86a50871bb53

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d6c942c5f48ecf21239c63d1cd9989590a9b6b78eb0c9d16f2ab9da6b95695f8
E MËPARSHMJA	3d71a5d86425682cd4f9bba283dc1455501ccbf9c91767aabe6ba28cbef93bd55
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d6c942c5f48ecf21239c63d1cd9989590a9b6b78eb0c9d16f2ab9da6b95695f8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

[Skip to content](#)

[Albeu.com](#)

- [lajme](#)
- [kosovë](#)
- [maqedoni](#)
- [sport](#)
- [showbiz](#)
- [lifestyle](#)
- [tech](#)
- [moti](#)
- [LiveTV](#)

search

- [lajme](#)
- [kosove](#)
- [maqedoni](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [lifestyle](#)
- [shendetesi](#)
- [receta gatimi](#)
- [enciklopedi](#)
- [english](#)
- [sport](#)
- [tech](#)
- [auto](#)
- [livescore](#)
- [REZULTATET ZGJEDHJET 2025](#)
- [moti në shqipëri](#)
- [moti në kosovë](#)
- [moti në maqedoni](#)
- [travel](#)

Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë kërkon dënim me 6 vite burgim për Thaçin për pengim të drejtësisë, mbrojtja kërkon lirimin e tij

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS), kërkoi që ish-presidenti i Kosovës të shpallet fajtor dhe të dënohet me gjashtë vite burgim, në rastin për pengim të drejtësisë pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë.

Kjo kërkesë iu drejtua gjykatësit të vetëm të rastit, Christopher Gosnell, nga prokurori i specializuar Joshua Hafetz, në fund të fjalës së tij përmbyllëse.

Prokuroria tha se nëse Thaçi shpallet fajtor, dënimi për këtë rast do ta vuante *"në vijim të ndonjë dënimi tjetër që do të jepet në rastin 6, nëse do të jepet"*.

Për të akuzuarit e tjerë në këtë rast, Prokuroria kërkoi që të gjithë të shpallen fajtor dhe të dënohen me burgim.

Prokuroria kërkoi që Hajredin Kuçi të dënohet me nëntë muaj burgim, ndërkaq, Fadil Fazliu, Isni Kilaj dhe Bashkim Smakaj të dënohen me nga tre vjet burgim secili.

"Akuzat që ZPS-ja ka ngritur dhe që ka vërtetuar janë krime. Përpjekja për të ndërhyrë dhe penguar procesin gjyqësor në këtë gjykatë, paraqet kërcënim për adresimin e drejtë të drejtësisë", tha prokurori Hafetz.

Në seancën e parë të shpalosjes së deklaratave përmbyllëse vetëm Thaçi është i pranishëm në gjykatore, ndërkaq të akuzuarit e tjerë janë duke e ndjekur seancën përmes video-lidhjes.

Mbrojtja dhe prokurorët do t'i kenë tri ditë kohë për t'i dhënë argumentet e tyre përmbyllëse në këtë rast që ndërlidhet me çështjen gjyqësore kundër Thaçit dhe tre ish-krerëve të tjerë të UÇK-së.

Pas Prokurorisë, radhën e ka mbrojtja e Thaçit.

Deklaratat përmbyllëse do të mbahen sot, nesër dhe të hënën e 14 shtatorit. Dy ditë pas përfundimit të deklaratave përmbyllëse, Thaçi së bashku me Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin do të dalin para trupit gjykues për t'u përballur me aktgjykimin për krime lufte gjatë luftës së viteve 1998-'99 në Kosovë. Për secilin nga ta, Prokuroria ka kërkuar 45 vjet burgim. Të katërtit i kanë mohuar të gjitha akuzat.

Prokuroria: Incizimet dhe dokumentet konfirmojnë përpjekjet për ndikim ndaj dëshmitarëve

Prokurorja e specializuar, Kimberly West, në nisje të fjalës përmbyllëse të ZPS-së tha se Thaçi dhe të bashkakuzuarit e tjerë për muaj të tërë tentuan të ndikonin në dëshmitë e dëshmitarëve për rastin gjyqësor për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

"Bashkë me bashkëpunëtorët e tij në këtë proces ai tentoi ta pengonte këtë proces duke ndërhyrë në dëshmitë e këtyre dëshmitarëve dhe u kap. U kap me shumë orë incizime dhe dokumente që konfirmojnë incizimet në fjalë", tha ajo.

West i cilësoi të bashkakuzuarit e tjerë të Thaçit, si bashkëpunëtorë të tij, shokë të devotshëm, lojalistë, dhe ish-vartës, të cilët, sipas saj, Thaçi i udhëzoi “që të shënjestronin dëshmitarët, dëshmia e të cilët, sipas tij, ishin vendimtare për procesin për krime lufte”.

West pretendoi se udhëzimet ishin të ndryshme, nga kërkesa për ndryshimin e dëshmimeve, apo që Thaçi të vihej apo të mos vihej në ndonjë vend ku pretendohet se janë kryer krime.

Sipas saj, duke krijuar grupe të vogla, Thaçi udhëzoi të bashkakuzuarit se si dëshmitë e dëshmitarëve t'i përshtateshin “narrativit të tij”.

Prokurorja tha se dëshmitë u printuan në qendrën e paraburgimit dhe u diskutuan gjatë vizitave po në këtë qendër.

Ajo po ashtu pretendoi se Thaçi kishte biseduar me të akuzuarit e tjerë edhe për hierarkinë e UÇK-së dhe si dëshmitarët, me dëshminë e tyre, siç tha ajo, të zbehnin rolin komandues të tij.

Prokuroria risjell pjesë të incizimeve

Më pas prokurori i specializuar, Joshua Hafetz, paraqiti edhe pjesë të incizimeve mes Thaçit dhe të bashkakuzuarve të tjerë, duke e akuzuar mbrojtjen se po tenton “t'i bishtnojë” provat, që sipas tij, kanë peshë të madhe.

Hafetz tha se pjesët që nuk janë dëgjuar mirë, Prokuroria nuk i ka përdorur, teksa shtoi se Thaçi gjatë udhëzimeve ka pëshpëritur.

Në gjykatore u shfaqën pjesë të bisedave të Thaçit me Fazliut lidhur me dëshminë e Rrustem Mustafës – Remit. Prokuroria pretendon se Thaçi, përmes Faziut dhe të birit të tij, e udhëzoi Mustafën se si të dëshmonte disa ditë më vonë në Hagë për rastin numër 6 – për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Prokuroria po ashtu tha se vetëm një ditë pas udhëzimit të Thaçit, Fazliu u kthye në Kosovë dhe kontaktoi Mustafën, përmes të birit të tij Fahri Fazliut, dhe disa ditë më vonë e njoftoi Thaçin për bisedën dhe Thaçi e udhëzoi sërish rreth dëshmisë së Mustafës.

“Dymdhëdhjetë orë pa rrëshqitur diku, s’mundet. Thuaj shkurt, ‘po’, ‘jo’. Ai i ka mirë deklaratat, por mund të rrëshqasë, se gjatë. Thuaji t’i shkurttoj”, dëgjohej Thaçi duke i thënë Fazliut në incizimin e lëshuar në gjykatë.

Prokurori Hafetz pretendoi se gjatë vizitave të Fazliut në qendrën e paraburgimit në Hagë, Thaçi zbuloi edhe informacione konfidenciale, përkatësisht identifikoi një provë për të cilën Mustafa do të pyetej gjatë dëshmisë dhe një libër për të cilën prokurorët do ta pyesnin. Sipas prokurorit, Thaçi dha udhëzime se si Mustafa do të duhej të dëshmonte.

Prokurori po ashtu përmendi një vizitë të Hajredin Kuçit me Thaçin në Hagë, në kohën kur Kuçi ishte pjesë e mbrojtjes së Veselit.

Ai tha se Kuçi e kontaktoi Mustafën përmes mesazhit, duke e ditur se është e ndaluar që të kontaktohen dëshmitarë pa një autorizim paraprak të gjykatës.

Prokuroria, tha se me këtë, Kuçi nuk iu bind gjykatës.

Madje, për të përshkruar raportin e ngushtë, që sipas Prokurorisë ekziston mes Thaçit dhe Kuçit, gjatë vizitës në Hagë, Prokuroria tha se Kuçi iu referua 90 Thaçit me fjalën “boss [shef]”, ndërsa Thaçi e quajti mbi 50 herë atë “Hajro”.

Prokuroria pretendon se Thaçi shënjestroi tre dëshmitarë përmes Kuçit, dy ish-pjesëtarë të UÇK-së dhe një viktimë e pretenduar e pjesëtarëve të UÇK-së.

“Shënjestrimi i dëshmitarëve ishte që ai [Thaçi] të përgatiste narrativin e tij të preferuar se ai nuk kishte përgjegjësi penale për veprat e paraqitura në çështjen 6”, tha prokurori Hafetz.

Hafetz tha se njëri nga dëshmitarët e shënjestruar ishte Sylejman Selimi, apo i njohur si dëshmitari numër 5.

Sipas prokurorit, gjatë takimit të 3 shtatorit 2023, Thaçi e udhëzoi Kuçin që Selimi të thoshte se komandantët e zonave të UÇK-së kishin fuqinë e vetme.

“Thuaj që telefonin satelitor ja ka sjellë diaspora... [Adem] Demaçi ka bërë disa rregullore”, dëgjohej duke përshpëritur Thaçi në incizimin e lëshuar në gjykatore.

Me Kuçin u diskutua edhe libri për të cilin do të pyetej Mustafa dhe, sipas Prokurorisë, përmes Kuçit, Thaçi dërgoi udhëzime se si Selimi të dëshmonte.

Dëshmitari tjetër, që sipas Prokurorisë, Thaçi e udhëzoi Kuçin se si të dëshmonte ishte Bislim Zyrap, i njohur si dëshmitari numër 2.

Sipas organit ndjekës, në incizime, Thaçi kërkonte që Zyrap të ndryshonte dëshminë e tij – pasi paraprakisht e kishte paraqitur atë si autoritet mbi Shtabin e Përgjithshëm – dhe të thoshte se ai, Thaçi dhe persona të tjerë, përfshirë Veselin u bënë anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në nëntor të vitit 1998.

“Thaçit i nevojitet të japë përgjigje të sakta për strukturën e Shtabit të Përgjithshëm, që të minimizonin përgjegjësinë penale të tij para nëntorit '98”, tha prokurori.

Sa i përket dëshmitarit të tretë, ai u identifikua vetëm si dëshmitari 6, pasi është dëshmitar i mbrojtur. Prokurori tha nuk mund të japë publikisht detaje për të, por udhëzimet e Thaçit, sipas tij, ishin që ai të mos implikohej drejtpërdrejt nga ky dëshmitar në ndonjë krim.

Prokuroria më pas vazhdoi me përfshirjen e Kilajt në këtë rast. Prokurori tha se Kilaj e vizitoi fillimisht Thaçin në shkurt të vitit 2023 – disa ditë pasi Thaçi kishte pranuar identitetet e dëshmitarëve të mbrojtur.

Në vizitë ishin të pranishëm edhe persona të tjerë. Prokuroria pretendon se në atë takim Thaçi udhëzoi Kilajn se si dëshmitarët të dëshmonin. Përkatësisht, bëhet fjalë për dëshmitarin e mbrojtur me numër 4.

Më pas Kilaj e vizitoi Thaçin sërish në tetor, kur sipas Prokurorisë, Thaçi i dha dëshminë e dëshmitarit dhe i kërkoi saktësisht se çfarë të ndryshonte.

Në incizime, sipas Prokurorisë, Thaçi kërkon që duhet korrigjuar pjesa gjashtë, faqja shtatë dhe rreshti 9.

Dëshmitari, sipas Prokurorisë, e kishte implikuar Thaçin në keqtrajtim të pretenduar.

Materiale të dëshmisë së dëshmitarit dhe materiale konfidenciale, Prokuroria tha se iu gjetën në zotërim Kilajt si dhe udhëzime se si duhej të dëshmonte.

Në fund të fjalës përmbyllëse, Prokuroria foli për përfshirjen e Bashkim Smakajt në këtë rast.

Sipas Prokurorisë, ai ishte udhëzuar nga Thaçi se si duhej të dëshmonte Bislim Zyrap. P

Prokuroria tha se Smakajt i është gjetur në makinën personale edhe një dokument konfidencial, të cilën pretendoi se e mori nga qendra e paraburgimit në Hagë nga Thaçi.

Po ashtu, ZPS tha se Smakaj ishte takuar dhe kishte komunikuar me Zyrapin pas vizitës në Hagë.

Prokurori tha se incizimet tregojnë modelin e ndjekur nga Thaçi, duke kërkuar që Zyrapit t'i kërkohej të dëshmonte shkurt dhe të përgjigjej “nuk më kujtohet” apo “nuk e di” për tema të caktuara.

Akuzat për pengim të drejtësisë

Thaçi, si dhe Smakaj, Kilaj, Fazliu dhe Kuçi, akuzohen se, mes prillit dhe nëntorit 2023, kishin ndikuar të dëshmitë e dëshmitarëve të thirrur nga prokurorët për çështjen gjyqësore për krime lufte kundër vetë Thaçit dhe ish-krerëve të tjerë të UÇK-së.

Thaçi përballet me tri akuza për tentim për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe tetë akuza për shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe mosbindje ndaj gjykatës.

Smakaj, Kilaj dhe Fazliu përballen, secili, me nga një akuzë për tentim për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe një akuzë për mosbindje ndaj gjykatës.

Ndërsa, Kuçi përballet dy akuza për mosbindje ndaj gjykatës.

Që të pestit janë vetëdeklaruar të pafajshëm.

Gjykimi ndaj tyre filloi më 27 shkurt, ndërsa më 13 mars, Prokuroria përfundoi paraqitjen e provave.

Nëse Thaçi shpallet i pafajshëm për krime lufte, a lirohet menjëherë?

Në Kosovë janë ngritur pyetje nëse ish-presidenti mund të kthehet menjëherë në vend, në rast se gjykata e liron nga akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Në bazë të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Gjykatës Speciale, “kur një i akuzuar i paraburgosur shpallet i pafajshëm, ai lirohet menjëherë, përveçse kur mbahet në paraburgim në mënyrë të lirishtme, ose uan një dënim për vepra penale të ndryshme nga ato në libër, me të cilët është shpallur i pafajshëm”

paraburgim në mënyrë të ngjashme, ose tani nga dënim për vepra penale të ngjashme nga ato në mënyrë me të cilat kanë shpallur paraburgim.

"Në rastin e zotit Thaçi, paraburgimi është urdhëruar nga trupi gjyqësor në procesin ndaj tij për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, si dhe nga gjyqtari i vetëm në procesin e veçantë ndaj tij për pengim të drejtësisë. Prandaj, nëse zoti Thaçi shpallet i pafajshëm në procesin për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, çështja nëse ai do të vazhdojë të mbahet në paraburgim do të vendoset nga gjyqtari i vetëm që po shqyrton rastin për pengim të drejtësisë", kishte thënë në gusht për Radion Evropa e Lirë zëdhënësi i Dhomave të Specializuara, Michael Doyle.

Gjykatësi i vetëm duhet të rishikojë çdo dy muaj nëse paraburgimi vazhdon të jetë i arsyeshëm.

"Ai mund ta shajtojë këtë çështje edhe me kërkesë të të akuzuarit, nëse ka pasur ndryshim të rrethanave", shtoi Doyle.

Vendimin e fundit, të dhjetin me radhë për vazhdimin e paraburgimit, gjykatësi i vetëm e lëshoi më 31 korrik, duke vlerësuar se ende ekziston rreziku që Thaçi të pengojë procedurat ose të kryejë vepra të tjera penale.

Në të njëjtin vendim, gjykatësi caktoi edhe afatet për rishikimin e radhës të paraburgimit: Thaçi mund të paraqesë parashtresat e tij deri më 7 shtator. Nëse ai nuk e bën këtë, Prokuroria duhet të paraqesë qëndrimin e saj deri më 14 shtator, ndërsa Thaçi mund të përgjigjet deri më 21 shtator.

Thaçi ndodhet në qendrën e paraburgimit në Hagë që nga nëntori i vitit 2020, kur u arrestua nën akuzë për krime lufte.

Që atëherë, mbrojtjes së Thaçit i janë hedhur poshtë të gjitha parashtresat për lirim nga paraburgimi. Madje, atij nuk iu pranua as një dorëzani prej 50 mijë eurosh, së bashku me disa kushte që Thaçi u zotua t'u përmbahej, në këmbim të lirit nga paraburgimi.

Akuzat për krime lufte

Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi, akuzohen për vepra si vrasje, torturim dhe përndjekje, gjoja të kryera gjatë viteve 1998-'99 gjatë luftës për pavarësimin e Kosovës nga Serbia.

Që të katërtit i kanë mohuar këto akuzë dhe janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që përfshijnë rreth 155 viktima.

Prokurorët kanë kërkuar që ata të shpallen fajtorë dhe secili të dënohet me nga 45 vjet burgim për krimet e pretenduara.

Mbi 130 dëshmitarë dëshmuan, ndërsa u pranuan me shkrim 160 deklarata të dëshmitarëve të tjerë në këtë gjyq gjatë tri vjetëve seanca.

Gjyqi ndaj tyre përfundoi në shkurt.

Gjykata Speciale është formalisht pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës por përbëhet nga gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë.

Gjykimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së ka hasur në kundërshtime të shumta në Kosovë, pasi është parë si e njëanshme, duke qenë se në të nuk përfshihen krimet e kryera nga serbët në territorin e Kosovës.

Prej atëherë, nëpër Kosovë janë vendosur pankarte e pllakate të mëdha me mesazhin "Liria ka emër" dhe fotografi të ish-krerëve të UÇK-së.

Gjithashtu ka pasur protesta kundër këtij procesi në Hagë, në Prishtinë dhe në qytete të tjera.

Mijëra qytetarë morën pjesë në protestën "Drejtësi, jo politikë" në Ditën e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt këtë vit në Prishtinë, në përkrahje të Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit./ REL

Lajme të ngjashme:

Shtuar më 10.09.2026 15:23

 [OVL UÇK: Prokuroria e njëanshme po përpaket të mbulojë dështimet me kërkesat e fundit](#)

[OVL UÇK: Prokuroria e njëanshme po përpaket të mbulojë dështimet me kërkesat e fundit](#)

 [Kurti përruron Parkun e Erës në Zatriq, projekt me vlerë rreth 106 milionë euro](#)

[Kurti përruron Parkun e Erës në Zatriq, projekt me vlerë rreth 106 milionë euro](#)

 [Në Gjermani, ushtarët e Kosovës zhvillojnë stërvitje me forcat amerikane](#)

[Në Gjermani, ushtarët e Kosovës zhvillojnë stërvitje me forcat amerikane](#)

 [Ku përfunduan 53 milionë eurot, zoti Gjini?" – Bekteshi sfidon AAK-në pas vendimit për Pal Lekajn](#)

[Ku përfunduan 53 milionë eurot, zoti Gjini?" – Bekteshi sfidon AAK-në pas vendimit për Pal Lekajn](#)

 [ZPS-ja kërkon dënimin e Thaçit me 6 vjet burg, paraqet masat edhe për katër të akuzuarit e tjerë](#)

[ZPS-ja kërkon dënimin e Thaçit me 6 vjet burg, paraqet masat edhe për katër të akuzuarit e tjerë](#)

 [ZPS-ja kërkon këto dënime për Kuçin, Fazliun, Kilajn, Smakajn dhe Thaçin](#)

[ZPS-ja kërkon këto dënime për Kuçin, Fazliun, Kilajn, Smakajn dhe Thaçin](#)

 [KGJK shqyrton raportet gjashtëmujore të gjykatave dhe kërkon efikasitet më të lartë](#)

[KGJK shqyrton raportet gjashtëmujore të gjykatave dhe kërkon efikasitet më të lartë](#)

 [Gjini takohet me ambasadorin norvegjez, bisedojnë për politikën dhe gjendjen e sigurisë](#)

[Gjini takohet me ambasadorin norvegjez, bisedojnë për politikën dhe gjendjen e sigurisë](#)

Posted in [kosovë](#), [Kryesore](#), [lajme](#)

të fundit

 [Deco zbulon detajet e ofertës së Barcelonës për Julian Alvarez dhe qëndrimin e Atletico](#)

[Deco zbulon detajet e ofertës së Barcelonës për Julian Alvarez dhe qëndrimin e Atletico](#)

NEWS AND MEDIA SERVICES PROVIDED BY ALBEU ONLINE MEDIA

 [Edon Zhegrova shkëlqen në stërvitjen e Juventusit, kalon Bremerin e Kalulun dhe realizon](#)

[Edon Zhegrova shkëlqen në stërvitjen e Juventusit, kalon Bremerin e Kalulun dhe realizon](#)

 [Festa e 35-vjetorit të pavarësisë kushtoi 5.53 milionë euro, zbulohet burimi i financimit](#)

[Festa e 35-vjetorit të pavarësisë kushtoi 5.53 milionë euro, zbulohet burimi i financimit](#)

 [BE përgatit kuadër të ri për qiratë ditore, qytetet mund t'i kufizojnë në zonat me krizë strehimi](#)

[BE përgatit kuadër të ri për qiratë ditore, qytetet mund t'i kufizojnë në zonat me krizë strehimi](#)

 [Courtois tërhiqet përkohësisht nga Belgjika, zbulohet arsyeja pas vendimit](#)

[Courtois tërhiqet përkohësisht nga Belgjika, zbulohet arsyeja pas vendimit](#)

 [Skandali i "call center-ave" në Ukrainë, DW: Nën hetim edhe zyrtarë të Prokurorisë](#)

[Skandali i "call center-ave" në Ukrainë, DW: Nën hetim edhe zyrtarë të Prokurorisë](#)

 [OVL UÇK: Prokuroria e njëanshme po përpaket të mbulojë dështimet me kërkesat e fundit](#)

[OVL UÇK: Prokuroria e njëanshme po përpaket të mbulojë dështimet me kërkesat e fundit](#)



[Esim for Global](#) | [Esim for Europe](#) | [Esim for Caribbean](#) | [Esim for USA](#) | [Esim for Italy](#) | [Esim for Spain](#) | [Esim for Turkey](#) | [Esim for Germany](#) | [Esim for Greece](#) | [Esim for Asia](#) | [Esim for World Cup 2026](#) | [Esim for Saudi Arabia](#) | [Esim for Egypt](#) | [Esim for United Arab Emirates](#) | [Esim for Balkans](#) | [Esim for Morocco](#) | [Esim for China](#) | [Esim for United Kingdom](#) | [Esim for Africa](#) | [Esim for Latin America](#) | [Esim for GCC Gulf Cooperation Council](#) | [Esim for Middle East](#) | [Esim for South America](#) | [Esim for Canada](#) | [Esim for Mexico](#) | [Esim for Japan](#) | [Esim for Albania](#) | [Esim for Kosovo](#) | [Esim for Switzerland](#) | [Esim for Tunisia](#) | [Esim for South Africa](#) | [Esim for Algeria](#) | [Esim for Portugal](#) | [Esim for Brazil](#) | [Esim for Argentina](#) | [Esim for Colombia](#) | [Esim for Hong Kong](#) | [Esim for Thailand](#) | [Esim for Macau](#) | [Esim for Malaysia](#) | [Esim for Vietnam](#) | [Esim for South Korea](#) | [Esim for Austria](#) | [Esim for Netherlands](#) | [Esim for Australia](#) | [Esim for Russia](#) | [Esim for India](#) | [Esim for Chile](#) | [Esim for Peru](#) | [Esim for Poland](#) | [Esim for North Macedonia](#) | [Esim for Sweden](#) | [Esim for Finland](#) | [Esim for Norway](#) | [Esim for Belgium](#)

[Albeu.com](#)

© 2003 - 2026 Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kryesore

- [Erion Veliaj](#)
- [Free Esim](#)
- [Zgjedhjet 2025](#)
- [Belinda Balluku](#)
- [SPAK](#)
- [Kombëtarja](#)

Kategori

- [Lifestyle](#)
- [Showbiz](#)
- [Tech](#)
- [Shëndetësi](#)
- [Argetim](#)
- [Enciklopedi](#)

Linqet

- [Live tv shqiptare](#)
- [Moti në Shqipëri](#)
- [Travel](#)
- [Horoskopi](#)
- [Livescore](#)
- [News from Albania](#)

Tags

- [Edi Rama](#)
- [Albania News](#)
- [Ilir Meta](#)
- [Piranjat](#)
- [gazeta, tv, portale](#)
- [Sali Berisha](#)

Moti

- [Moti në Tiranë](#)
- [Moti në Prishtinë](#)
- [Moti në Shkup](#)
- [Moti në Durrës](#)

- [Moti në Prizren](#)
- [Moti në Tetovë](#)

© 2003 - 2026 Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

- [Kontakti](#)
- [Kushtet e Përdorimit](#)
- [Privacy Policy](#)
- [Powered by: orihost.com](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.